


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. I faq	01-3842/12
Broj stranica	02
Nr. pages	
Data	24.10.2012
Biro/Unit	
Prot. No.	
Datum	
Dati	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 19.09.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I.** Mbyllët rasti më nr. AKK-03-5081/1, për z. Sylen Vranica, Drejtor i Klinikës Neurologjike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se i ka bërë ndryshimet e kërkuar nga Agjencia dhe nuk ushtron më funksion udhëheqës në biznesin e tij privat.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokollit AKK-03-5081/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Sylen Vranica, Drejtor i Klinikës Neurologjike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Klinikës Neurologjike ne Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), si person i autorizuar dhe pronar në biznesin N.P.SH “Reflexi” e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 09.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë

me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave me datën 27.03.2012 z.Vranica, Drejtor i Klinikës Neurologjike në Qendrën Klinike Universitare te Kosovës, është ardhur në takim në zyre e AKK-së, dhe na ka njoftuar se e ka marrë shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me gjerësisht përsituatën qe dyshohet për Konflikt te mundshëm te Interesit.

Gjatë takimit e kemi njoftuar përsituatën që gjendet z.Vranica, ku edhe ai vet është pajtuar por kemi marrë zotimin se do të shfrytëzoj të gjitha mundësit dhe në afatin ligjore do te bejë ndryshimet e kërkuar në biznesin privat dhe nuk do të menaxhoj me atë biznes ku edhe tash faktikisht nuk menaxhon por ka mbetur ashtu si është regjistruar biznesi.

Pas këtij takimi e kemi kontaktuar ne telefon edhe njëherë z.Vranica për të parë se në cilën fazë gjendet, na ka informuar se për shkake të problemeve teknike qe ju kanë shfaqur nuk ka mundur të bëjë ndryshimet mirëpo është në procedurë dhe sa ma shpejt qe të jetë e mundur do të sjell dëshmitë nga ARBK-ja, për ndryshimet në biznese.

Me datën 18.09.2012, z. Sylen Vranica, ka sjellë në Agjenci dëshminë e lëshuar nga ARBK-ja se nuk ushtron me pozitë udhëheqëse në biznes por ka mbetur vetëm si bashkëpronarë, ndërsa e menaxhon një person qe është emëruar nga bashkëpronarct.

Andaj në bazë te dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z.Sylen Vranica, Drejtor i Klinikës Neurologjike ne Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nuk gjendet me ne situatën e përshkruar si konflikt te mundshëm te interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit Publik pasi qe nuk ushtron me pozitën e menaxherit ne biznesin privat pasi qe ka emëruar si person te autorizuar një tjetër person për ta menaxhuar biznesin.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i Klinikës Neurologjike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës dhe pozitës ne funksionin si udhëheqës në Biznesin private N.P.SH "Reflexi".

Konstatojmë se pas ndryshimeve që janë bërë dhe gjendjes faktike tash, z. Sylen Vranica, Drejtor i Klinikës Neurologjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nuk gjendët ne situatën e konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

